

VENDIM
Nr. 788, datë 11.12.2019

**PËR PËRBËRJEN DHE RREGULLAT E DETAJUARA PËR ORGANIZIMIN,
FUNKSIONIMIN E SHPËRBLIMIN FINANCIAR TË KOMISIONIT QENDROR
TË STATUSIT “DËSHMOR I ATDHEUT”**

(Ndryshuar me VKM nr. 80, datë 5.2.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 5, të nenit 10, të ligjit nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pranë Ministrisë së Mbrojtjes krijohet Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut”, që kryesohet nga ministri i Mbrojtjes (kryetar), zëvendësministri i Mbrojtjes (nënkryetar) dhe në përbërje ka anëtarë:

- zëvendësministrin e Brendshëm;
- zëvendësministrin e Drejtësisë;
- zëvendësministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- një përfaqësues të Organizatës së Dëshmorëve të LANÇ-it dhe dëshmorëve të tjerë të atdheut;
- një përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it.

2. Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut” mbështetet nga një staf teknik, që funksionon pranë Ministrisë së Mbrojtjes, përbërja dhe organizimi i të cilit përcaktohet nga ministri i Mbrojtjes. Përgjegjësi i këtij stafi ushtron funksionet e sekretarit të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”.

3. Marrja e vendimeve të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut” do të kryhet sipas dispozitave të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

4. Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut” mblidhet me kërkesën e kryetarit të komisionit dhe ushtron këto detyra:

a) shqyrton dhe merr vendime lidhur me *kërkesën* dhe dokumentacionin për shpalljen apo njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, të dërguar *përmes portalit “e-Albania”* nga subjektet *kërkuese*;

b) shqyrton dhe merr vendim lidhur me ankesat administrative të subjekteve kërkuese, *të dërguara përmes portalit “e-Albania”*, kundër vendimit të këshillit bashkiak, këshillit të qarkut apo prefektit, të cilët kanë refuzuar kërkesën e tyre për statusin e dëshmorit të atdheut ose kur këto organe nuk kanë marrë në shqyrtim kërkesën e tyre për këtë çështje, brenda afateve të parashikuara ligjore;

c) njofton *përmes portalit “e-Albania”* subjektin *kërkuës* apo subjektin ankues se *kërkesa* ose ankesa e tij është pranuar për vazhdimin e procedurës administrative nga Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut” ose për plotësimin e të metave lidhur me kriteret formale, ligjore, të *kërkesës*, duke caktuar një afat prej 10 ditësh pune për plotësimin e këtyre të metave;

ç) njofton *përmes portalit “e-Albania”* subjektin *kërkuës* apo subjektin ankues se janë të nevojshme veprime të mëtejshme administrative, para se të vendosë pranimin ose jo të *kërkesës* apo të kërkesës/ankesës, duke caktuar një afat prej 10 ditësh pune për kryerjen e këtyre veprimeve;

d) bashkëpunon me organet shtetërore qendrore e vendore dhe me organizatat e dëshmorëve apo organizata të tjera për organizimin e ceremonive të dhënies (shpërndarjes) së certifikatës “Dëshmor i atdheut” dhe të simbolit “Familje e dëshmorit të atdheut”;

dh) rishqyrton vendimet e tij, të cilët, bazuar në një vendim gjykatë të formës së prerë, janë anuluar apo shfuqizuar;

e) miraton, me vendim, dhënien e shpërblimit financiar mujor për familjen e dëshmorit të atdheut, kur plotësohen kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 18, të ligjit nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”;

ë) bashkëpunon me institucionet e tjera publike gjatë hetimit administrativ të një çështjeje për shpalljen apo njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”;

f) ngarkon stafin teknik të komisionit qendror me detyra specifike administrative, për çështjen që shqyrton;

g) njofton, *përmes portalit "e-Albania"*, subjektin *kërkesues* apo subjektin ankues, brenda afateve ligjore, për vendimin përfundimtar të Komisionit Qendror të Statusit "Dëshmor i atdheut";

gj) merr vendim për delegimin e disa kompetencave nënkryetarit, një anëtarit apo stafit teknik të Komisionit Qendror të Statusit "Dëshmor i atdheut".

5. *Kërkesa* për shpalljen ose njohjen e statusit "Dëshmor i atdheut" përmban identitetin e plotë e të saktë të të ndjerit, jetëshkrimin të tij dhe përshkrimin e saktë të rrethanave të ngjarjes ku ka humbur jetën, sipas dokumenteve zyrtare, shtetërore dhe çdo dokumentacion tjetër, të përcaktuar sipas nenit 8, të ligjit nr. 109/2018, "Për statusin e dëshmorit të atdheut", dhe *i dërgohet nëpërmjet portalit "e-Albania"* këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose prefektit.

6. *Kërkesa* për shpalljen ose njohjen e statusit "Dëshmor i atdheut" paraqitet pranë stafit teknik të Komisionit Qendror të Statusit "Dëshmor i atdheut", në Ministrinë e Mbrojtjes *nëpërmjet portalit "e-Albania"*.

7. Komisioni Qendror, për dhënien e statusit "Dëshmor i atdheut", shqyrton dokumentet e dërguara nga këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, prefekti ose ministri përkatës dhe relacionin e stafit teknik. Komisioni Qendror merr vendimin brenda 3 muajve, nga dita e regjistrimit në sekretarinë e këtij komisioni, për shpalljen ose jo "Dëshmor i atdheut" të të ndjerit dhe njofton të interesuarin nëpërmjet këshillit të qarkut, këshillit bashkiak dhe prefektit *nëpërmjet portalit "e-Albania"*.

8. Vendimi i Komisionit Qendror për mosdhënien e statusit "Dëshmor i atdheut" duhet të jetë i arsyetuar.

9. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar, bëhet sipas përcaktimeve në vendimin normativ të masës së shpërblimit të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore.

9.1 Deri në momentin e krijimit të infrastrukturës së nevojshme teknike për ofrimin e shërbimeve përmes portalit "e-Albania", pritja dhe trajtimi i aplikimeve do të vijojë të kryhet sipas mënyrave dhe mjeteve ekzistuese.

10. Vendimi nr. 151, datë 25.5.2002, i Këshillit të Ministrave, "Për statusin 'Dëshmor i Atdheut'", shfuqizohet.

11. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Komisioni Qendror i Statusit "Dëshmor i atdheut" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe